



ANEKS KONTRATA

Date: 16.10.2020

Në mes të

Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

"Toifor" adresa **Prishtinë** përfaqësuar nga **Isuf Zymeri**, me numër të regjistrimit të biznesit **810484890**, në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **Meremetimi i rrugëve rurale me zhavor** me nr. të prokurimit **615-19-8354-5-2-1**, nr i brendshëm **61519099521** të datës: **04.12.2019**, e cila kontratë është në realizim e sipër

Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për **Meremetimi i rrugëve rurale me zhavor - punë shtesë**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës **06.09.2020** me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **14,012.97 €**
(katërbëdhjetë mijë e dybëdhjetë euro nëntë dhjetë e shtatëcent sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [61519099521/5].
3. Punët shtesë kontrahohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas përfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.
7. Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbaron sipas planit dinamik e që është 10 ditë

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	Rasim Fejza	Emri:	Isuf Zymeri
Pozita:	menaxher i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.10.2020	Data:	16.10.2020
Vula:		Vula:	